



## FTESË PËR ANKAND PUBLIK (Dhënia e hapësirave/lokalet me qira)

### 1. Dhënia e hapësirave afariste me qira

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë njofton të gjithë të interesuarit se ofron hapësirat/lokalet për qiradhënie përmes procedurës së ankandit publik, si në vijim:

Nr.	Njësia	Sipërfaqja/m <sup>2</sup>	Nr. i lokalit/hapësirës	Çmimi fillestar/€
1.	Sportel	3.00	3	200.00
2.	Sportel	3.00	4	200.00
3.	Sportel/Lokal	6.76	35	189.28

Shënim: Të gjitha çmimet janë pa TVSH.

Kriteri i dhënies së kontratës është çmimi më i lartë i ofruar. Në rast që ekziston vetëm një ofertë (me e vogël se çmimi fillestar) lidhur me njësinë afariste të caktuar, Bordi i Drejtoreve të ndërmarrjes ka të drejtë të bëjë negociata me palën e interesuar lidhur me çmimin final të njësisë afariste të caktuar.

Preferencat e dëshirueshme për lëshimin hapësirave me qira gjatë procesit të ankandit:

- Për sportelin nr.3 dhe nr.4 preferohet zyre, apo veprimtari e ngjashme për kompanitë autotransportuese;
- Për sportelin/lokalin nr.35 preferohet zyre, apo veprimtari të ngjashme, për kompani autotransportuese, apo ndonjë veprimtari tjetër e lejuar dhe e cila nuk bën ndesh me veprimtarinë e NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë ;

Të drejtë pjesëmarrje kanë personat juridik. Si dëshmi ofrojnë certifikatën e regjistrimit të biznesit. Afati i dhënies me qira është një (1) vjeçar me mundësi vazhdimi, bazuar në rregulloren e brendshme lidhur me lëshimin e hapësirave me qira dhe vendosjen e objekteve.

### 2. Kushtet dhe obligimet tjera

- Nga e drejta e pjesëmarrjes në ankand janë të përjashtuar të gjithë debitorët që kanë obligime të pa shlyera ndaj ndërmarrjes NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë.
- Të gjitha palët e interesuara mund t'i shikojnë hapësirat/lokalet çdo ditë pune nga ora 08:00 deri me 16:00.
- Afati për dorëzimin e ofertave është deri me 14.05.2024, ora 14:00, hapja e ofertave bëhet në orën 14:30.
- Ofertat dorëzohen në zarfe të mbyllura dhe dorëzohen në zyrën e arkivit të ndërmarrjes.
- Të drejtë pjesëmarrje në hapjen e ofertave kanë të gjithë ofertuesit.
- Palët fituese në afatin prej 5 ditësh pas mbylljes së procedurës së ankandit duhet të nënshkruajnë kontratat mbi qiranë, dhe të bëjnë pagesën e faturës së pare.
- Informatat me të hollësishme mund të merren përmes email-t: **contact@sap-rks.com** apo në numër të telefonit 038 551 333.